



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2377/Prot

Tiranë, më 25/08/2020

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr.107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.181 prot, datë 21.09.2020 “Njoftim për shpalljen e vendit të lirë, Specialist i burimeve njerëzore/Jurist pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër” të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër, protokolluar pranë AKPA-s me nr.2377 prot, datë 24.09.2020, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 28.09.2020, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- Specialist i burimeve njerëzore/Jurist pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2.Kritere të posaçme

- a) të ketë nivelin arsimor në fushën e kërkuar në shpalljen për pozicionin përkatës;
- b) të ketë përvojë në punë sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Dokumentet e aplikimit

a) letërmotivimi për pozicionin;

b) CV (jetëshkrimi), e cila plotësohet sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,

c) fotokopje e kartës së identitetit, e diplomës dhe e librezës së punës;

d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

e) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

f) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

h) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

i) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Dokumentet e aplikimit të dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër, brenda datës 07.10.2020.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

